

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit të Organizimit dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/2000, 44/2002, 82/2008, 167/2010, 51/2011 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19 dhe 110/19), nenit 50 të Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/2008, 103/2008, 24 /2011, 80/2012, 24/2013, 147/2013, 41/2014, 145/2015, 154/2015, 30/2016 dhe 53/2016 dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së 257/20 dhe 16/24), nenit 3 paragrafit 3 të Rregullores për realizimin e të drejtës së shpërblimit të njëhershëm për botimin e punimit shkencor dhe për kompensimin e mjeteve për botimin e punimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 102/2018), dhe plotësimit të Raportit të punës së Komisionit për dhënien e propozimit të ministrit për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët aplikuan për ndarjen e mjeteve të njëhershme për punim kërkimor-shkencor të botuar për vitin 2021, nr. 15-4023/1 datës 22.12.2023, ndërsa në përputhje me Planin Financiar të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës për vitin 2024, ministri i Arsimit dhe i Shkencës, solli:

AKTVENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Aktvendimit për financimin e kërkesave të pranuar për punimet kërkimore- shkencore nga autorë vendas të botuara në revista shkencore ndërkombëtare me faktor ndikimi (impakt faktor) për vitin 2021 numër 15-1023/2 të datës 13.04.2023.

1. Me këtë Aktvendim shtohen kërkesat në vazhdim nga autorë të punimeve kërkimore-shkencore konform Konkursit për ndarjen e mjeteve financiare të njëherëshme për botim të punimit kërkimor- shkencor për vitin 2021.

P. Bp.	Autor	Titulli i punimit	Revista	Faktor ndikimi	Parashtrues	vërejtje
1.	Borçe Makrijovski	Profili i përbërjes së aminoacideve në djathin maqedonas me shëllirë të bardhë	Gazeta Aziatike nga fusha e Kimisë	0,9	Fakulteti i Shkencave Bioteknike, Universiteti "Shën Kilementi i Ohrit", Manastir	Të pranuar
2.	Ariant Reka	Mikrostrukturë- mekanike K-Mg-Al-Si-O-F qeramika e qelqit të dopuar me Ag/Au	RSC Advances	4,036	Universiteti Shtetëror i Tetovës	Të pranuar

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e sjelljes të tij.

Arsyetim

Në bazë të nenit 2 të Rregullores për realizimin e së drejtës për shpërblim të njëhershëm për punim shkencor të botuar dhe për kompensimin e mjeteve për botim të punimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 102/2018) është shpallur Konkurs për ndarjen e mjeteve të njëhershme financiare për punim shkencor-kërkimor të botuar për vitin 2021 me nr. 15-4095/1 datë 31.3.2022, Në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës deri më 01.10.2022 janë dorëzuar gjithsej 304 kërkesa nga autorë për ndarjen e mjeteve për punim shkencor-kërkimor të botuar në revistë ndërkombëtare me faktor ndikimi. Në përputhje me nenin 3 paragrafin 1 të Rregullores për realizimin e së drejtës për shpërblim të njëhershëm për punim shkencor të botuar dhe për kompensim të mjeteve të paguara për botim të punimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 102/2018), kërkesat e dorëzuara i shqyrtuan pesë anëtarë të komisionit profesional të formuar nga ministrja e Arsimit dhe i Shkencës me Aktvendimin nr. 15-4095/2, datë 29.8.2022 dhe përgatiti plotësimin e Raportit nga puna e Komisionit për dhënien e propozimit të Ministres për përgjedhjen e kandidatëve të cilët aplikuan për ndarjen e mjeteve të njëhershme në të holla për botim të punimit kërkimor shkencor për vitin 2021, nr. 15-4023/1 të datës 22.12.2023, dhe Raportin e punës së Komisionit për dhënien e propozimit për ndarjen e mjeteve financiare për punim kërkimor shkencor të botuar në revistë ndërkombëtare me faktor ndikimi për vitin 2021 deri te Ministrja e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 15-3673/3 të datës 11.07.2024. Kërkesat që janë shqyrtuar në mënyrë shtesë i plotësojnë kushtet konform konkursit. Sipas fushave shkencore, në mënyrë shtesë financohen punimet kërkimore-shkencore nga: "Shkencat tekniko-teknologjike"-1 dhe "Shkencat bioteknike"-1.

Shtesa e Aktvendimit për financimin e punimeve kërkimore-shkencore të pranuar nga autorë vendas të botuara në revista shkencore ndërkombëtare me faktor ndikimi (impakt faktor) për vitin 2021 sipas fushave shkencore, e sjellë Ministrja në bazë të kushtit konkurrues për ndarja e mjeteve për financimin e punimit të botuar shkencor-kërkimor vendas në revistë ndërkombëtare me faktor ndikimi (impakt faktor) për vitin 2021, plani financiar i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për vitin 2024 dhe Programi për veprimtarinë kërkimore-shkencore për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 41/24).

Në bazë të asaj që u potencua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.